

# Shlyerja e Shpëtimtarit

MATERIALI I SEMINARIT PËR DHIATËN E RE

Fragmentet e shkrimeve të shenjta dhe thënia e mëposhtme na mësojnë për Shlyerjen e Jezu Krishtit. Kushtoj 10 deri në 15 minuta leximit me kujdes të këtyre burimeve (ose burimeve të tjera rreth Shlyerjes së Shpëtimtarit për të cilat je i/e interesuar të mësosh ose që i ke gjetur para këtij mësimi). Ndërsa lexon, mendo mbi faktin se si secili prej këtyre burimeve të ndihmon ta kuptosh më mirë atë që Ati Qjellor dhe Jezu Krishti bënë për ty dhe pse.

- Lluca 22:39–44
- Lluca 23:33–38, 44–46
- Gjoni 3:14–17
- Alma 7:11–13
- 3 Nefi 27:14
- Doktrina e Besëlidhje 18:10–11
- Doktrina e Besëlidhje 19:16–19

Plaku Ted R. Kelister, i Të Shtatëdhjetëve, dha mësim:



“Çfarë është atëherë Shlyerja e Jezu Krishtit? Në një kuptim, ajo është një seri ngjarjesh hyjnore që filluan në Kopshtin e Gjetsemanit, vazhduan në kryq dhe kulmuan me Ringjalljen e Shpëtimtarit nga varri. Ajo ishte e nxitur nga një dashuri që nuk arrijmë ta kuptojmë, për secilin prej nesh. Ajo kërkonte një qenie që ishte pa mëkat; i cili kishte pushtet të pafund mbi elementet – edhe mbi vdekjen; i cili zotëronte një aftësi të pakufishme për të vuajtur pasojat e të gjitha mëkateve dhe lëngatave tona dhe i cili, në fakt, zbriti nën gjithçka [shih Doktrina e Besëlidhje 88:6]. Ky ishte misioni i Jezu Krishtit – kjo ishte Shlyerja e Tij.

Cili ishte qëllimi i saj atëherë? Ishte të bënte të mundur që ne të kthehemi në praninë e Perëndisë, të bëhemi më shumë si Ai dhe të kemi plotësi gëzimi.

Kjo u bë duke mposhtur katër pengesa:

1. Vdekjen fizike
2. Vdekjen shpirtërore të shkaktuar nga Adami dhe nga mëkatet tona
3. Vuajtjet dhe sëmundjet tona
4. Dobësitë dhe papërsosuritë tona.”

(Ted R. Kelister, “Shlyerja e Jezu Krishtit”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2019, f. 85)